

Aktivitet Kombëtar

“Rritja e rolit të studentëve në qeverisjen dhe menaxhimin e IAL-ve”

Organizuar më Tiranë në 24.05.2018 nga

Zyra Erasmus +/Shqipëri në bashkëpunim me grupin e Ekspertëve për Reformën në Arsimin e Lartë Shqiptar (HERE), dhe me praninë e Ekspertes E. Lewis (EU expert)

Tavolina e rumbullakët në formatin e një Workshopi interaktiv u zhvillua në ambientet e Universitetit Politeknik, në një frymë diskutimesh e debate konstruktive, shoqëruar me pyetje dhe shqetesime konkrete sjellë nga pjesëmarrës përfaqësues të studenteve në senate të IAL-ve, studentë të tjerë, përfaqësues të organeve/strukturave të IAL-ve dhe personel akademik.

Aktivitetin e përshëndeti Z. Ervin Demo, Zv. Minister Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Z. Akli Fundo Zv/Rektor i Universitetit Politeknik të Tiranës.

E pranishme me dy prezantime ishte edhe ekspertja e ftuar në këtë aktivitet Prof. E. Lewis.

Grupi organizator pasqyron në vijim disa nga çështjet kryesore të evidentuara, në formën e konkluzioneve dhe rekomandimeve që do t'i përcillen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me synimin për të kontribuar realisht në rritjen e rolit të studentëve në qeverisjen dhe menaxhimin e IAL-ve.

Koncepti i angazhimit të studentëve i referohet përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse në institucionet e arsimit të lartë në lidhje me qeverisjen, menaxhimin, sigurimin e cilësisë, mësimdhënien dhe të mësuarit (mësimnxënien). Ai konsiderohet gjithashtu një proces dypalësh ku studentët janë përgjegjës për nivelin e të nxënies dhe angazhimit të tyre, por nga ana tjetër ky angazhim varet gjithashtu nga kushtet, politikat/kultura institucionale që u mundësojnë atyre të përfshihen më tej.

IAL inkurajohen qe te sigurojne pjesemarrjen e studenteve jo vetem ne senate, por edhe ne vendimarrjenne nivel fakulteti ose departamenti.

Këshillat studentore është e rëndësishme të shtojne mekanizmat për mbështetjen dhe këshillimin e studentëve për arritje të suksesshme në vazhdimësi të studimeve, përgatitjen dhe suksesin në karrierë si dhe drejt orientimit për punësim. Organizimi i tyre rekomandohet të jetë në nivel kapilar për të dhënë mesazhin e gjithëpërfshirjes.

Mbështetur ne Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015, neni 46, IAL–ve iu rekomandohet që të ngrenë dhe përdorin në mënyre efektive e eficiente komisionet e përhershme për:

- Garantimin e standarteve të sigurimit të cilësisë
- Mbarëvajtjen e veprimtarise se IAL dhe marrëdhëniet me studentet.

Numri i anëtareve (pedagoge dhe student) ne komisionin e fundit, rekomandohet të jetë jo më pak se 10.

Realizimi i pyetësorëve për studentët duhet të zhvillohet si një praktike e mirë në ndihmë të mbledhjes së të gjitha reagimeve thelbësore, grupuar nën çdo element të përvojës së të nxënit të studentëve duke përfshirë: Kurrikulën, Burimet e mësimit, Vlerësimin dhe feedback, Pranimin, Progresin dhe Arritjet e studentit, Udhëzimet dhe mbështetjen nda jtyre, Për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë. IAL duhet te sigurojne transparencen ne te gjithe aktivitetin e tyre, duke garantuar qe pyetesore te studentit te jene anonim. Ky shqetësim bëhet present për pjesën më të madhe të studentëve, të cilët pranojnë se nuk ndjehen të lire në plotësimin e pyetësorëve dhe shpesh madje edhe nën presion.

Praktika e Pjesëmarrjes së studentëve në qeverisjen e arsimit të lartë dhe veçanerisht në shqyrtimin e cilësisë duhet të jetë një element integral dhe thelbesor i Standardeve për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë Shqipëtar. IAL inkurajohen që studentet do të jenë pjesë e komisioneve të jashtme/brendshme për vlerësimin e cilësisë. Kjo duhet të shoqërohet me trajnimin e studentëve-vleresues,

nga ASCAL, kërkesë kjo e shprehur nga vetë studentët dhe nga pervojat me te mira te universiteteve evropiane.

Duke qënë se përfshirja e studentëve në rritjen e rolit të tyre në qeverisjen dhe menaxhimin e IAL-ve sjell përgjegjësi dhe kërkesa të mëtejshme për ta, mekanizmat e sigurimit të llogaridhënies, transparences dhe informimit për studentët e tjerë duhet të jenë prioritare, në mënyrë që çdo student të ndjehet realisht i përfaqësuar.

IAL inkurajohen për një mbështetje më të madhe të Këshillave studentore, duke e shprehur edhe ne dokumentat themelore te tyre. Aprovimi i Statutit IAL konsiderohet nje detyrim paresor për një zhvillimin e rolit të Këshillave studentore dhe te vetë studenteve në tërësi.

Këshillat studentore duhet të konstituohen zyrtarisht që të marrin përgjegjësitë për të përçuar realisht zërin e studentit, pasi shpesh ka rezultuar të jenë fiktive në pasqyrimin e problematikave studentore. MASR rekomandohet që të monitorojë procesin.

Për forcimin e rolit të studenteve ne IAL, rekomandohet qe ASCAL të punojë ne mënyrë permanente për jo vetem monitorimin e zbatimit të kërkesave të Kodit të Cilesisë, por edhe për krijimin e një kulture të përfshirjes së studenteve në procesin e sigurimit të cilësisë në IAL. Po në këtë kontekst shikohet edhe angazhimi i saj për ngritjen e sistemit te brendshem te sigurimit te cilesise ne IAL.

Raportuese

Prof. Asoc. Dr. Fatmira SHEHU

Moderatorë

Prof. Dr. Anila PAPARISTO

Prof. Asoc. Dr. Flamur BIDAJ

Tiranë, 24.05.2018